

Data __. __. 2022

PROCESVERBAL – Procedurë e Hapur, e thjeshtuar - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “FURNIZIM DHE VENDOSJE E KAMERAVE TE
SIGURISE”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 35125300-2
Kamera sigurie**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 4 114 027 (katër milion e njëqind e katërbëdhjetë mijë e njëzet
e shtatë) Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor, Bashkia Vau Dejës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës në masën 2% të vlerës së fondit limit;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP si dhe në nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Këto kërkesa vendosen për të provuar se operatori ekonomik vepron konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

2 Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit, konkretisht **1 645 611 (një milion e gjashtëqind e dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë)** lekë pa TVSH.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, pika 2/c e nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara 2020,2021 për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të njohur me gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik të paktën për dy vitet e fundit, për të patur siguri që operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej, perkatesisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar (duke pasë parasysh që objekti është i ndarë në lote dhe për përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore duhet të referohemi vlerës së lotit).* Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e procedurave të zhvilluara më parë, rëndësisë së objektit të prokurimit, rëndësisë së Autoritetit Kontraktor, seriozitetit të marrëdhënieve kontraktuale me operatorë ekonomikë me aktivitet të vazhdueshëm në treg gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit*

financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas kësteve përkatëse bazuar në përcaktimet në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2022.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 "Për QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKR" i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose **822 805 (tetëqind e njëzet e dy mijë e tetëqind e pesë)** lek pa TVSH.

Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera dhe afati i përfundimit dhe fatura tatimore të shitjes, të **plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit** në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ose

Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të **plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë të Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës. Për shkak të rëndësisë që ka vet Autoriteti Kontraktor, llojit të mallit objekt prokurimi, i rëndësishëm për kryerjen e detyrave funksionale dhe profesionale të trupës së Prokurorisë së Posaçme, me

qëllim që të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg, me performancë të mirë e të vazhdueshme, aplikojmë marzhin maksimal të vlerës së parashikuar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për produktet objekt kontrate, ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vertetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar ose me kontratë individuale pune të vlefshme, diplomë / certifikatë kualifikimi nga institucione të akredituara stafin e mëposhtëm:

- a) 1 (një) Inxhinier elektronik / IT
- b) 1(një) teknik fibrash optike
- c) 2 (dy) punonjës për montimin e kamerave të pajisur me dëshmi kualifikimi

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Në preventivin e mallrave parashikohet të vendosen rreth 11.6 km fibër optike, prandaj është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën ***një teknik për fibrat optike***. Gjithashtu do të montohen 5 (pesë) lloje të ndryshme kamerash, sistem survejimi etj, prandaj për të kryer punimet me cilësi OE duhet të ketë të punësuar ***2 (dy) punonjës të kualifikuar*** për realizimin e kësaj kontrate në afatin e caktuar.

3 ***(një) Inxhinier elektronik / IT*** është i nevojshëm për drejtimin e punimeve për shtrirjen e fibrave optike, pikat e lidhjes, krijimin e sallës operative në ambientet e AK etj.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë të menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015**. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akredituese të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve, pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së .

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që do të kryejë furnizimin dhe vendosjen e mallrave të kërkuar në një afat kohor prej 43 ditësh kalendarike.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë AK që do të respektohet afati kohor i vendosur.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie për artikujt e kërkuar dhe në rast shpallje fitues duhet ti lëshojë Autoritetit Kontraktor fletë garanci si më poshtë vijon:

- 1 IR PTZ AI Network Camera – 2 vite
- 2 Kamera IP 8MP Bullet WDR – 2 vite
- 3 Kamera IP 6MP Bullet Motorized WDR – 2 vite
- 4 Active Deterrence 5 MP IP Full Color Camera – 2 vite
- 5 IRLZF Kamera ANPR – 2 vite
- 11 PDU Power Distributor Unit – 2 vite

- 26 Bateri 100 A e thate – 2 vite
- 27 Inverter 500 W ne pikat e vendosjes se kamerave – 2 vite
- 28 Inverter 3000 W – 2 vite
- 29 Bateri 200 A e thate – 2 vite

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre.

- 6. Operatori ekonomik në datën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë mostra për artikujt si më poshtë:

- 1 IR PTZ AI Network Camera
- 2 Kamera IP 8MP Bullet WDR
- 3 Kamera IP 6MP Bullet Motorized WDR
- 4 Active Deterrence 5 MP IP Full Color Camera
- 5 IRLZF Kamera ANPR
- 7 Hard Disk me Kapacitet 10TB
- 8 Switch 8-Port PoE 96 Watt
- 12 Kabllo UTP Cat6 (me meter linear)
- 22 HDMI 10m
- 23 Fiber Optike
- 26 Bateri 100 A e thate
- 27 Inverter 500W në pikat e vendosjes se kamerave

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në specifikimet

teknike të hartuara nga personi përgjegjës nuk janë përdorur emra markash, vetëm në ato raste kur është konsideruar e pashmangshme nga hartuesi i specifikimeve teknike, por AK në vlerësimin e mallrave të OE do të pranojë artikuj ekuivalentë me të njëjtat specifikime teknike të kërkuara.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është:

Data: **27/10/2022**; Ora: **11:00**; Vendi: www.app.gov.al